

Shtojca 13.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Data 15/04/2025

Drejtuar: **Drejtuar: BOE “Caushi M” shpk** *Perkatesisht me Nr.Nipti:L884198010 me adrese : Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakastër, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati I-re, Zona Kadastrale 1090, Nr Pasurie 7/9810/Ndertese & “K.M.K” shpk* *Perkatesisht nr.NIPTI : L78223801E me adrese : Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/Ndertese*

Operatorit Ekonomik (OE) **ose**

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës:Pune

Lloji i Procedurës së prokurimit:E hapur

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Sistemi asfaltim i rruges fshati Funares Zdranjsh faza II ,Njesia Administrative Orenje”

Numri i referencës së procedurës /Lotit:REF: 38021-02-13-2025

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 5 muaj

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 07/04/2025

Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit : **Buletini Nr. 18 datë 14 Prill 2025**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE “Kupa”shpk & “Kronos Konstruksion”shpk	K51615512C K41416033P
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>Numri i NIPT-t</i>

Vlera **35,950,334 (tridhjetë e pesë milion e nentëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e kater) leke pa tvsh**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO x

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. BOE “Caushi M” shpk & “K.M.K” shpk	L88419801O L78223801E
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>Numri i NIPT-it</i>

Vlera **36,759,650(tridhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e nente mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. OE “L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k

L78006801F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **34.919.069,88 (tridhjetë e kater milion e nenteqind e nentembedhjete mijë e gjashtedhjetë e nente pike tetedhjetë e tete) leke pa tvsh**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. BOE “APIS Construction” shpk&

L41513008A

“Rafin Company” shpk

L52125110A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **39,540,642.80 (tridhjetë e nente milion e peseqind e dyzet mijë e gjashteqind e dyzet e dy pike tetedhjetë) lekë pa Tvsh**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I. OPERATORI EKONOMIK L.T.E CONSTRUCTION SHPK NUK PLOTESON PIKEN 2.2.3 :

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, **për vitin 2023 - 2024 ne te gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin** referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument ne momentin e dorezimit te dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2023, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontrates.

Operatori ekonomik L.T.E CONSTRUCTION SHPK ka nënshkruar kontratën nr.3390 prot, date 16.07.2024 me Bashkinë Librazhd me objekt “Sistemim asafaltim i rruges së fshatit Vehcan, faza e I-re Njesia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”.

Ne zbatim të kontratës dhe detyrimit ligjor për pagimin e taksave dhe tarifave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar duhet të hapë NIPT sekondar dhe të paguajë taksat dhe tarifën vendore për periudhën nga data 15.07.2024 deri në datë 31.12.2024. Rezulton që subjekti L.T.E CONSTRUCTION SHPK me NIPT L78006801F nuk ka paguar detyrimet për taksë dhe tarifë vendore për vitin 2024 në Bashkinë Librazhd si vend ku aktualisht ushtron aktivitetin.

Sipas fatures për arketim nr.50996 date 11.09.2024 subjekti L.T.E CONSTRUCTION SHPK me NIPT L78006801F ka pa paguar taksë dhe tarifë vendore në vlerën 62,500 leke.

Në këtë rast nuk ka nevojë për dokument provues nga operatori ekonomik pasi K.V.O pranë Bashkisë Librazhd disponon listën e subjekteve debitore dhe rezulton që në institucionin ku OE merr pjesë në prokurimin publik **nuk ka paguar** taksat dhe tarifën vendore për vitin 2024.

Deklarimi i bërë në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit është I pasakte pasi rezulton që deri në datën 04.03.2025 taksat dhe tarifën vendore për vitin 2024 nuk janë paguar nga subjekti L.T.E CONSTRUCTION SHPK me NIPT L78006801F .*

Përsa me sipër Operatori Ekonomik nuk ploteson kriterin nr.2.2.3.

II. OPERATORI EKONOMIK L.T.E CONSTRUCTION SHPK NUK PLOTESON PIKEN 2.3.4 :

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbeshtetes, punonjësit specialiste dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar si drejtues Teknik në stafin e tij për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vertetuar

me kontrate pune te vlefshme, diplome, CV, si dhe te figurojne detyrimisht ne listpagesat e shoqerise per periudhen e kerkuar ne piken 2.3.4, stafin inxhinierik si me poshte:

- 1 (nje) **Inxhinier Ndërtimi**
- 1 (nje) **Inxhinier Mekanik**
- 1 (nje) **Inxhinier Gjeoded (Topograf)**
- 1 (nje) **Inxhinier Hidroteknik**
- 1 (një) **Inxhinier Gjeoteknik**
- 1 (nje) **Inxhinier Hidrogjeolog**

Pika a) Stafi mbeshitetes qe Operatori ekonomik duhet te kete te disponoje dokumentacionin qe verteton profesionin si: Dëshmi profesionale te punonjesve ose ekuivalent te tij/saj, , punonjesit e meposhtem me specialitetin si dhe te figurojn ne listpagesat e shoqerise sipas pikes mesiperme (2.3.4)

Ne formularin e vetdeklarimit Ka deklaruar 5 punonjes asfalti **por nuk specifikon nr e Amzes** sic ka specifikuar punonjesit e tjetër , sic kerkohet ne kriteret e pergjithsme te kualifikimit pika 2.3.4

Persa me siper Operatori Ekonomik nuk ploteson kriterin nr.2.3.4.

III. OPERATORI EKONOMIK L.T.E CONSTRUCTION SHPK NUK PLOTESON PIKEN 2.3.5 :

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e *Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”*.
- **1(nje)** prej ixhinierëve, pjese e stafit te shoqerise duhet te jete i certifikuar si Eskpert per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis.
(Për ekspertin e Mjedisit certifikata e ekspertit Mjedisor si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).
- **1(nje)** prej ixhinierëve, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për *“Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015”*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

(Për pergjegjesin e kontrollit te cilesise duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit).

*** *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori fitues duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër.

Nuk Disponon 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1(nje) prej ixhinierëve, pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për ”Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015”, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj. Pasi Certifikata Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015 duhet ta disponoj Inxhinieri sic kerkohet ne Piken 2.3.5 Persa me siper Operatori Ekonomik nuk ploteson kriterin nr.2.3.5.

IV. OPERATORI EKONOMIK L.T.E CONSTRUCTION SHPK NUK PLOTESON PIKEN 2.3.1 (MAKINERI, PAJISJE)

a) **Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) te cilat duhet te jene ne pronesi te tij ose me qira te vertetuara keto me dokumentacionin perkates;**

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 12 – 15 ton	2 cope	Pronesi ose me qera
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10 – 12 ton	2 cope	Pronesi ose me qera
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 5-10 ton	2 cope	Pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 1.5-2 ton	1 cope	Pronesi ose me qera

Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronesi ose me qera
Grejder me goma (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
Minifadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
Damper me goma (mjet teknologjik me goma) 20 ton – 25 ton	2 cope	Pronesi ose me qera
Dumper (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronesi ose me qera
Autobetoniere vetngarkuese 2.5-3 m ³ (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronesi ose me qera
Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir	1 cope	Pronesi ose me qera
Autovinç mbi 20 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Autobitumatrice	1 cope	Pronesi ose me qera
Autobot uji	1 cope	Pronesi ose me qera
Koke terheqese	1 cope	Pronesi ose me qera
Rimorkiator mbi 50 ton per transportin e makinerive	1 cope	Pronesi ose me qera
Rul gome – hekur mbi 16 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Rul gome – hekur mbi 8-10 ton	2 cope	Pronesi ose me qera
Rul asfalti hekur – hekur 1- 3 ton	2 cope	Pronesi ose me qera
Rul hekur – hekur mbi 8 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Depozite uji 5000 l	1 cope	Pronesi ose me qera
Vibrator	2cope	Pronesi ose me qera
Helikopter nivelues	1 cope	Pronesi ose me qera
Armature	min 1000 m	Pronesi ose me qera
Betoniere 0.25-0.5 m ³	1 cope	Pronesi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronesi ose me qera
Instrument per punime gjeodezike	1 cope	Pronesi ose me qera
Makineri Vijezi	1 cope	Pronesi ose me qera
Deflektometer Shtresash	1 cope	Pronesi ose me qera
Fabrike Betoni jo me larg se 50 km (me planvendosje/genplan) pajisur me QKL / mobile e levizeshme	1 cope	Pronesi, me qera ose aktmarveshje furnizimi
Fabrike Asfalti jo me larg se 50 km (me planvendosje/genplan) pajisur me QKL/ mobile e levizeshme	1 cope	Pronesi, me qera ose aktmarveshje furnizimi

- b) Gjithashtu ne zbatim te VKM-se Nr.312, date 05.05.2010, operatori ekonomik pjesemarres duhet te disponoje mjete dhe pajisje mbrojtjes ne pune te punetoreve, personelit, si me poshte:
- Kokore – jo me pak se 25 cope
 - Jeleke – jo me pak se 25 cope
 - Prozhektore ndriçimi naten – jo me pak se 15 cope
 - Komplet i ndihmes se shpejte – jo me pak se 5 cope
 - Fikese zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra – jo me pak se 10 cope
 - Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt – jo me pak se 10 cope
 - Ripa sigurie – jo me pak se 20 cope

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ne formularin e vetdeklarimit e paraqitur nuk disponon Mjetet si me posht :
Damper me goma (mjet teknologjik me goma) 20 ton – 25 ton 2 cope
Persa me siper Operatori Ekonomik nuk ploteson kriterin nr.2.3.1.

V. OPERATORI EKONOMIK L.T.E CONSTRUCTION SHPK

Operatori ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk aktualisht ka ne proces zbatimimi 1 (nje) kontrate me Bashkine Librazhd.

Kontraten nr.3390 prot, date 16.07.2024 me Bashkine Librazhd me objekt “Sistemim asafaltim i rruges se fshatit Vehcan, faza e I-re Njesia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”.

Mjetet e deklaruar ne kontratat qe ka ne zbatim ne Bashkine Librazhd jane deklaruar edhe ne kete procedure prokurimi. Per kete mjetet/pajisjet/makinerite e deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit dalin te angazhuara ne kontrata ne proces punimesh ne Bashkine Librazhd.Ne ditën e vleresimit te kesaj procedure prokurimi KVO ka konstatuar rruga nuk ka perfunduar.

Gjithashtu ne Kontraten nr.3390 prot, date 16.07.2024 me Bashkine Librazhd me objekt “Sistemim asafaltim i rruges se fshatit Vehcan, faza e I-re Njesia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd” drejtuesi teknik dhe I gjithë stafi drejtues eshte I angazhuar.

Persa me siper nuk mund te jete i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e prokurimit ne proces vleresimi.

Per sa me lart KVO vendos skualifikimin e OE “L.T.E CONSTRUCTION SHPK

- **Eshte skualifikuar BOE “Kupa”shpk me nr.NIPTI :K51615512C & “Kronos Konstruksion” me nr.NIPTI:K41416033P , me oferte ekonomike 35,950,334 (tridhjetë e pese milion e nenteqind e pesedhjetë mijë e treqind e tridhjetë e kater) leke pa tvsh per arsye se :**

Ne datën 26.03.2025 jane klasifikuar te kualifikuar paraprak ne vleresimin e dokumentacionit te paraqitur ne SPE operatorete ekonomike te meposhtem:

- 1- Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION me oferte 35,950,334 leke pa tvsh.

- 2- Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “Caushi M” SH.P.K & K.M.K shpk, me oferte 36,759,650 leke pa tvsh.
- 3- Operatori Ekonomik “Apis Construction” shpk & “Rafin Company” shpk, me oferte 39,540,642.80 leke pa tvsh.

.... **si dhe** bazuar ne piken 1 dhe 5, te nenit 82, te Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;*
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.*

dhe bazuar piken 1, 6 dhe 7 te nenit 26, te VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

KVO verën se pas njoftimit nga ana e AK-se për dorezimin e dokumentacionit të ofertës janë paraqitur dhe kanë dorëzuar dokumentet, sipas parashikimit në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike me datë 03.03.2025, dhe të vlerësuar në datë 26.03.2025. Operatorët Ekonomik të mëposhtem:

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas marrjes në dorezim të dokumentacionit të dorëzuar nga Operatorët Ekonomik të sipërcituar, si dhe bazuar në nenin 82, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, të ndryshuar, mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar, konstatoi se:

- **Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION me oferte 35,950,334 leke pa tvsh.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit konstatohet se me procesverbalin datë 26.03.2025 për vlerësimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit me objekt: **“Sistemim asfaltim i rrugës fshati Funares Zdranjsh faza II ,Njesia Administrative Orenje”** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar **Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION** dhe me datën 26.03.2025, i ka kërkuar me anë të sistemit të Prokurimeve Elektronike dorezimin e dokumentacionit fizik origjinal ose kopje të njehesuar me origjinalin sipas parashikimit në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike deri me datën 03.03.2025 dhe vlerësuar paraprakisht në datë 26.03.2025.

Komisioni i vleresimit te Ofertave, verifikoi ne zyren e protokoll-arkives regjistrat e shkresave hyres ku nga verifikimi rezultoi se **Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION** nuk ka paraqitur asnje dokumentacion apo shkrese prane Bashkise Librazhd nga data e kerkeses se Autoritetit Kontraktor ne SPE pra data 26.03.2025 deri ne daten 02.04.2025.

Pas vleresimit te kryer nga KVO eshte njoftuar **Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION** i cili brenda afatit 5 ditor duhet te paraqese prane AK dokumentacionin fizik, bazuar ne dokumentacionin e ngarkuar ne SPE dhe deklarimet e bera ne formularin permbledhes te vetedeklarimit. Afati ligjor per paraqitjen e dokumentacionit eshte 5 dite kalendarike.

Afati sipas diteve kalendarike perfundon ne date 31.03.2025. Por duke gene se dita e fundit (e hene date 31.03.2025) eshte dite pushimi zyrtar, **Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION** eshte pritur per paraqitjen e dokumentacionit edhe ne daten 01.04.2025 (dite e marte).

Ka rezultuar se **Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION** nuk ka paraqitur asnje dokumentacion prane protokollit te Bashkise Librazhd. Per kete KVO kryen rivleresimin e procedures duke skualifikuar OE “KUPA” SHPK per shkak te mosparaqitjes se dokumentacionit fizik brenda afatit 5 ditor pas kryerjes se vleresimit paraprak ne SPE.

Ligji nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”,

Neni 56

Forma dhe mënyra e shpalljes së njoftimeve

1. Njoftimet e procedurave të prokurimit sipas këtij ligji publikohen në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë ligj, në sistemin e prokurimit elektronik dhe në mënyrë të shkurtuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i cili përgatitet dhe publikohet periodikisht.
2. Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, njoftimet publikohen edhe në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, me përjashtim të njoftimit të fituesit dhe njoftimit të procedurës së anuluar.
3. Në njoftimet që publikohen sipas këtij ligji, duhet të përfshihen të gjitha informacionet që u lejojnë operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e prokurimit.
4. Përmbajtja e njoftimeve përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

5. Afatet kohore në këtë ligj jepen në ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur ka specifikime të tjera.

Neni 95

Administrimi i informacionit në proces

1. Pas hapjes së ofertave dhe deri në shpalljen e ofertës fituese, asnjë ofertues nuk duhet të bëjë asnjë komunikim të pajustificuar me autoritetin kontraktor ose të përpiqet, në çfarëdo mënyre, për të ndikuar në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Pas hapjes së ofertave, informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin e ofertave dhe rekomandimet për ofertën fituese nuk u bëhen të njohura personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces, derisa të nënshkruhet kontrata.

3. Nëse disa pjesë të ofertës së operatorëve ekonomikë deklarohen ligjërisht si konfidenciale, atëherë këto dokumente nuk duhet të vihen në dispozicion të publikut.

Rezulton se Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION nuk ka bere asnje njoftim elektronik ne SPE ose shkresor qe angazhohet per te paraqitur dokumentacionin shkresor prane AK brenda 5 diteve ose ndonje njoftim qe kerkon m

e shume kohe per paraqitjen e dokumentacionit shkresor per shkak te ndonje rrethane te tij te forces madhore ose pamundesise per shkaqe te medha.

Asnje njoftim nuk ka ardhur ne Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) ose ne forme shkresore.

Neni 97

Njoftimi i fituesit

1. **Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave,** autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në formë shkresore, autoriteti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike. Me publikimin e njoftimit të fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.

3. Në rast se kontrata nuk nënshkruhet nga ofertuesi fitues për ndonjë situatë të forcës madhore, autoriteti kontraktor nuk mban sigurimin e ofertës.

4. Me “Forcë madhore” do të kuptohet një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend sipas legjislacionit në fuqi.

Vleresimi i ofertave është bërë në datë 26.03.2025 ora 09.48 (sipas të dhënave në sistem).

Brenda afatit 5 ditor Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION nuk ka paraqitur dokumentacionin për të provuar që deklaratimet e kryera në SPE plotësohen me dokumentacion shkresor.

Theksojmë se në nenin 26, pika 6, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet se “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur”.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave thekson se çdo operator ekonomik i cili kualifikohet paraprakisht pas vleresimit të dokumentacionit në SPE, ka detyrimin ligjor të paraqitjes fizikisht pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike në përputhje me nenin 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Per sa me lart, Komisioni i Vleresimit të Ofertave konstaton se BOE **Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION** nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion fizik origjinal apo kopje të njehesuar me origjinalin duke mos përbushur asnjë nga kriteret e parashikuara në DST.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pikat 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e **Bashkimit të Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION** për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Bashkimi I Operatoreve Ekonomike “KUPA” SHPK & KRONOS KONSTRUKSION skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “Caushi M” shpk** *Perkatesisht me Nr.Nipti: **L884198010** me adrese : Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakastër, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati I-re, Zona Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/Ndertese* & **“K.M.K” shpk** *Perkatesisht nr.NIPTI : **L78223801E** me adrese : Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/Ndertese* se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **36,759,650(tridhjetë e gjashtë milion e shtateqind e pesedhjetë e nente mijë e gjashtëqind e pesedhjetë) lekë pa tvsh** /pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkise Librazhd Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **39,540,642.80 (tridhjetë e nente milion e peseqind e dyzet mijë e gjashtëqind e dyzet e dy pike tetedhjetë) lekë pa Tvsh**, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO JO

Nëse Po (Nr.____ Datë____ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

**PERSONI I AUTORIZUAR I TITULLARIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
BAJRAM PISHKASHI**